VENDIM
Nr.132, datë 13.2.2008

PËR PARAQITJEN E KËRKESËS PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË DISA PREJ ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES TË ENTIT RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE DHE AUTORIZIMIN E MINISTRIT TË PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT TË PËRFAQËSOJË KËSHILLIN E MINISTRAVE, GJATË KËSAJ PROCEDURE, NË KUVEND

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6 të ligjit nr.9000, datë 30.1 2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe të neneve 84 e 86 shkronja ç" të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. T'i paraqesë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë kërkesën për shkarkimin e z. Hydajet Kopani nga detyra e anëtarit dhe kryetarit të këshillit drejtues të Enti Rregullator të Telekomunikacioneve, me motivacionin për mosushtrim përgjegjësie të ngarkuar me ligj, pa shkak të arsyeshëm.
2. T'i paraqesë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë kërkesën për shkarkimin e znj. Anila Kaçupi nga detyra e anëtarit të këshillit drejtues të Enti Rregullator të Telekomunikacioneve, me motivacionin për mosushtrim përgjegjësie të ngarkuar me ligj, pa shkak të arsyeshëm.
3. T'i paraqesë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë kërkesën për shkarkimin e z. Shyqyri Meka nga detyra e anëtarit të këshillit drejtues të Enti Rregullator të Telekomunikacioneve, me motivacionin për mosushtrim përgjegjësie të ngarkuar me ligj, pa shkak të arsyeshëm.
4. T'i paraqesë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë kërkesën për shkarkimin e z.Arjan Sinoimeri nga detyra e anëtarit të këshillit drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, me motivacionin për mosushtrim përgjegjësie të ngarkuar me ligj, pa shkak të arsyeshëm.
5. Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit autorizohet të përfaqësojë Këshillin e Ministrave, gjatë zhvillimit të kësaj procedure, në Kuvend.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha